

VENDIM
Nr. 856, datë 21.10.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1020, DATË 14.10.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE
TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN", TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të neneve 6 e 8, të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane, për rregullat e bashkëpunimit të asistencës për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)", dhe të neneve 10 e 11, të ligjit nr. 37/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para anëtarësimit (IPA II)", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7, të vendimit nr. 1020, datë 14.10.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

"7/1. Përveç kriterëve të përgjithshme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil, drejtori i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, duhet të plotësojë edhe këto kriterë:

- a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkencat ekonomike ose juridike;
- b) Të ketë, të paktën, 10 (dhjetë) vjet përvojë profesionale, nga të cilat, të paktën, 6 (gjashtë) vjet, në fushën e auditimit;
- c) Të gëzojë integritet të lartë moral e profesional.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama